

Elena Xhina (Duka)

Mban pozicionin e Avokates së Shtetit pranë Avokaturës së Shtetit, Zyra e Këshillimit dhe Koordinimit Ndërministror që nga muaji qershor 2023. Prej 10 vjetësh, ka ushtruar profesionin e Avokates dhe dhe që nga viti 2003 mban titullin avokat. Prej vitit 2016 mban titullin e Ndërmjetësës.

Në vitin 2015 ka ushtruar detyrën e Nënkryetares së Këshillit të Qarkut Elbasan. Ka qenë deputete e Kuvendit të Shqipërisë në legjislaturën IX-të, 2017-2021. Për dy vite ka punuar si Këshilltare e Ministrit të Drejtësisë, dhe më pas si Drejtoreshë Kabineti pranë Bashkisë Elbasan.

Prej vitit 2013 jep mësim si lektore pranë Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

Është trajnuar në fusha të ndryshme të së drejtës, si ajo e të drejtave të njeriut etj., si dhe ka vijuar studimet pasuniversitare në të drejtën publike.

Në vitin 2016 ka marrë titullin Doktor Shkencash në Drejtësi. Është autore e tre librave si dhe e një sërë punimesh shkencore në fushën e të drejtës. Botuese në disa revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare, në fushën e së drejtës.